

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 149/11 Prot.

Vlorë më, 19.01.2024

VENDIM
Nr. 1, datë 16.01.2024

PËR
NJË SAKTËSIM NË VENDIMIN NR.51, TË SENATIT AKADEMIK, DATË 05.10.2023
PËR NJË SAKTËSIM NE VENDIMIN NR.31 TË SENATIT AKADEMIK, DATË
20.06.2023 "PËR MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË
STUDIMIT BACHELOR NË INXHINIERI MEKANIKE, MIDIS UNIVERSITETIT
"ISMAIL QEMALI", VLORE DHE UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË BARIT,
ITALI"


Në mbështetje të nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS, datë 14.01.2020 si dhe referuar shkresës nr. 112, prot datë,15.01.2024 së Zëvendësrektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional, Senati Akademik në mbledhjen e datës 16.01.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin ardhur me shkresë nr.112, prot. datë, 15.01.2024, si më poshtë:
 - a) Rioorganizimi i programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Mekanike", në programin e studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Mekanike me Diplomë të dyfishtë me Universitetin Politeknik të Barit", me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), me formë studimi me kohë të plotë, në shqip dhe anglisht.
 - b) Pranimi i studentëve nga matura shtetërore bëhet në "BSc.Inxhinieri Mekanike në gjuhën shqipe".
 - c) Fillimi i implementimit të këtij programi studimi të jetë viti akademik 2024-2025.
2. Bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi shkresa nr. 112, prot, datë, 15.01.2024.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore të UV-së.
4. Ky vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.
5. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije MAS.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof.Asoc. Xhiliola Agaraj (Shehu)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Nr. 112 Prot.

Vlorë, më 15 / 01 / 2024

Lëndat: Kërkesë e saktësim të vendimit të senatit Akademik Nr. 31. Datë 20.06.2023

PROF. DR. ROLAND ZISI
KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

KËTU:

Bazuar në Urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 592, datë 18.10.2023 me Nr. 6551 Prot., datë 20.10.2023, protokolluar pranë Universitetit "Ismaïl Qemali" Vlorë me Nr. 1940 Prot., datë 23.10.2023 me lëndë "Dërgohet urdhëri për njohje dhe zbatim" si dhe bazuar në kërkesën e grupit mësimor Inxhinieri Mekanike dhe Navale D.I.T.D me Nr. 423/1 Prot., datë 23.11.2023 si dhe shkresën e MAS Nr. 6551/3 Prot. datë 12.01.2024 është e nevojshme saktësimi i vendimit të Senatit Akademik Nr. Nr. 31. Date 20.06.2023 me Nr. 1209/1 Prot. datë 20.06.2023 Për "Miratimin e Hapjes së Programit të Përbashkët të Studimit "Bachelor në Inxhinieri Mekanike" midis Universitetit "Ismaïl Qemali" Vlorë dhe Universitetit Politeknik të Barit" Itali.

Kjo vira si pasojë e nevojës së një saktësimi/korrigjimi në Urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 592, datë 18.10.2023 me Nr. 6551 Prot., datë 20.10.2023, protokolluar pranë Universitetit "Ismaïl Qemali" Vlorë me Nr. 1940 Prot., datë 23.10.2023 me lëndë "Dërgohet urdhëri për njohje dhe zbatim", me qëllim fillimin e implementimit të këtij programi studimi sipas legjislacionit në fuqi. Konkretisht:

- Në pikën 1 të Urdhërit është e nevojshme të specifikohet se programi i studimit duhet të jetë në dy gjuhë: në gjuhën shqip dhe në gjuhën angleze. Në bazë të marrëveshjes së firmosur midis Universitetit "Ismaïl Qemali" Vlorë dhe Universitetit Politeknik të Barit vetëm studentët që plotësojnë disa kritere (p.sh. studentët e UV-së të cilët kanë përfunduar të paktën semestrin e dytë të vitit të parë të studimeve, kanë minimalisht 48 kredite me një mesatare të paktën 7,00, me numërin maksimal të studentëve 20) do të kenë mundësi të aplikojnë për diplomë të përbashkët. Po ashtu, studentët e Universitetit Politeknik të Barit për të marrë një diplomë të dyfishtë duhet të kenë përfunduar të paktën semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve, të kenë minimalisht 120 kredite me një mesatare të paktën 25. Bazuar në këto, vetëm një pjesë e studentëve do të kenë mundësinë të marrin një diplomë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORE

ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

të dyfishtë ndërsa të tjerët do të vazhdojnë normalisht studimet sipas programit aktual në gjuhën shqipe. Po ashtu, referuar planeve mesimore të programit bazë në Inxhinieri Mekanike dhe plan programit të dakortësuar në Shtojcën A të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis UV-së dhe Universitetit Politeknik të Barit kemi një ndryshim prej 24 kreditesh (lëndët MEK 340 Menaxhim Industrial i Cilësisë 6 Kredite, MEK 256 Motora me Djegie të Brendëshme 6 Kredite, EE 275 Mekatronike 6 Kredite, MEK 388 Aplikime Kompjuterike në Inxhinieri Mekanike 6 Kredite), nuk zhvillohen nga studentët e përfshirë në diplomë të dyfishtë pasi ata ndjekin disa lëndë të tjera që ofrohen sipas profilit të diplomës Bachelor në Inxhinieri Mekanike të ofruar në Universitetin Politeknik të Barit.

- Në pikën 2 të Urdhërit është e nevojshme të ndryshojë fillimi i ofrimit të këtij programi studimi. Studentët të cilët janë regjistruar sivjet në këtë program studimi, janë futur në një program tjetër (Bachelor në Inxhinieri Mekanike në gjuhën shqipe sipas aplikimit të bërë në sistemin u-albania) dhe nuk është e mundur që të aplikojnë për program të përbashkët. Fillimi i implementimit të këtij programi studimi duhet të jetë viti Akademik 2024-2025.

Për këtë arsye propozojmë që në Vendimin e Senatit Akademik të përfshihet:

1. Riorganizimi i programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Mekanike”, në programin e studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Mekanike me Diplomë të dyfishtë me Universitetin Politeknik të Barit”, me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), me formë studimi me kohë të plotë, në shqip dhe anglisht.
2. Pranimi i studentëve nga matura shtetërore bëhet në “BSc. Inxhinieri Mekanike në gjuhën shqipe”.
3. Fillimi i implementimit të këtij programi studimi të jetë viti Akademik 2024-2025.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

ZV. REKTOR

PROF. ASOC. ENKELEJD MËHILLI